Ky projekt është financuar
nga Bashkimi Evropian

Kyprojektpoimplementohet
nga FAO

**Projekti: "Integrimi i Programit Kombëtar për Konsolidimin e Tokës" (MAINLAND)**

**Marrëveshja e Delegacionit 2016/382315**

**Thirrja Nr. 1/GCP/MCD/002/EC/2019**
**për shprehjen e interesit për pjesëmarrje në konsolidimin e tokës**

Të nderuar,

Projekti i financuar nga Bashkimi Evropian "Integrimi i Programit Kombëtar për Konsolidimin e Tokës" (MAINLAND) i implementuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi (FAO) dhe nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU)fton të gjitha grupet e pronarëve të tokave bujqësore që të marrin pjesë në Thirrjen Publike për Shprehjen e Interesit për Pjesëmarrje në Konsolidimin e Tokës.

Të drejtën e pjesëmarrjes gëzojnë grupet e pronarëve të tokave, tokat e të cilëve janë brenda territorit të njëjtë (brenda një apo më tepër fshatrave, ose brenda një pjese të një fshati/pozicioni mikro, që paraqesin pjesë të një apo disa komunave rurale kadastrale fqinje).

Për të shprehur interesin për pjesëmarrje në Thirrjen, pronarët e tokës duhet dërguar një Formular të plotësuar dhe të nënshkruar të Deklaratës së Interesit.

Ekzemplarët e botuar të Udhëzimit dhe të Formulareve të Deklaratës së Interesit mund të merren në:

- Zyrën e Projektit, që ndodhet në hapësirat e MBPEU në Shkup (Zyra nr. 211), Adresa: Aminta Treti, Nr. 2, 1000 Shkup
- Departamentin e Konsolidimit të Tokës, Shkëmbimit dhe Identifikimit të Parcelave, MBPEU, Adresa: Aminta Treti, Nr. 2, 1000 Shkup
- Zyrat rajonale të MBPEU (Aneksi2: Lista e kontakteve të zyrave rajonale të MBPEU)
- Zyrat rajonale të Agjencisë për Nxitjen e Zhvillimin të Bujqësisë (ANZHB) (Aneksi 3: Lista e kontakteve të zyrave rajonale të ANZHB)

Udhëzimi dhe Formulari i Deklaratës së Interesit mund të shkarkohen dhe në formatin elektronik në linqet e mëposhtme:

- http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/faoweb/FAO-and-MAFWE/Call-for-Expression-of-interest-LC-ALB.pdf
- http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/faoweb/FAO-and-MAFWE/Expression-of-interest-LC-Form-ALB.pdf
- http://www.mzsv.gov.mk/Events.aspx?IdRoot=1&IdLanguage=3&News=535
- https://eeas.europa.eu/delegations/republic-north-macedonia/area/jobs-funds_en

Deklaratat e Interesit mund të dërgohen drejtpërsëdrejti në zyrat rajonale të MBPEU, me postë ose e skanuar me e-mail,me shënimin "Për Thirrjen Nr. "1/ GCP/MCD/002/EC/2019".

Afati për paraqitjen e Deklaratës së Interesit është data 1 korrik 2019, deri në ora 16:00 (në rast se janë dërguar me postë, do të merren parasysh data dhe koha që janë shënuar në vulën postale).

Deklaratat e Interesit që do të dërgohen pas skadimit të afatit përfundimtar, nuk do të shqyrtohen.

Nr. 1/ GCP/MCD/002/EC/2019
Shkup, 12.06.2019

Vilma Daugaliene
Këshilltare Kryesore Teknike

Republika e Maqedonisë së Veriut
**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave**

**PËRMBAJTJA**

1 INFORMACIONET E PËRGJITHSHME DHE KUSHTET KRYESORE .................................... 3

2 PËRGATITJA DHE PARASHTRIMI I DEKLARATËS SË INTERESIT .................................... 6

3 PROCEDURA PËR PËRZGJEDHJEN E ZONAVE TË PROJEKTIT .......................................... 7

4 KORNIZA KOHORE INDIKATIVE................................................................................ 9

ANEKSI 1. DEKLARATA E INTERESIT PËR PJESËMARRJE NË KONSOLIDIMIN E TOKËS .. 10

ANEKSI 2. LISTA E KONTAKTEVE TË ZYRAVE RAJONALE TË MBPEU ................................ 13

ANEKSI 3. LISTA E KONTAKTEVE TË ZYRAVE RAJONALE TË AGJENCISË PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË ............................................................................ 14

ANEKSI 4. PYETËSORI PËR GRUMBULLIMIN E INFORMACIONEVE PLOTËSUESE PËR KOMUNITET LOKAL ............................................................................ 15

# 1 INFORMACIONET E PËRGJITHSHME DHE KUSHTET KRYESORE

## 1.1 Hyrje

Ky dokument përmban udhëzime për pronarët e tokave që janë të interesuar për Thirrjen Publike për Shprehjen e Interesit për Pjesëmarrje në Konsolidimin e Tokës Nr. 1/ GCP/MCD/002/EC/2019.

## 1.2 Shpallësi i Thirrjes

Shpallësi i Thirrjes është projekti i financuar nga BE me titull "Integrimi i Programit Kombëtar për Konsolidimin e Tokës (MAINLAND)" i implementuar nga FAO me zyrë në adresën:Aminta Treti, Nr. 2, 1000 Shkup, numri i telefonit: +389 2 3134 477 (lokali 708), e-mail-i:FAO-MK@fao.org, ueb faqja: www.fao.org/in-action/mainstreaming-national-land-consolidation-programme

## 1.3 Lënda e Thirrjes

Lëndë e Thirrjes është të ftohen gjithë pronarët e tokave që janë të interesuar që të shprehin interesin për pjesëmarrje në konsolidimin e tokës.

Në bazë të Deklaratave të Interesit të grumbulluara dhe konform procedurës së prezantuar më poshtë në pjesën 3, do të përzgjedhen zona projekti me potencialin më të madh për konsolidimin e tokës.

Zonat e përzgjedhura të konsolidimit do t'u nënshtrohenstudimeve të zbatueshmërisë për të vlerësuar zbatueshmërinë e konsolidimit të tokës. Në rastin e rekomandimeve pozitive nga studimet e zbatueshmërisë, zonat e projektit poashtu do të jenë lëndë e mbështetjes së mëtejshme për zbatimin e projekteve për konsolidimin e tokës në terren. Të gjitha shpenzimet lidhur me implementimin e projekteve për konsolidimin e tokës do të mbulohen nga projekti MAINLAND, ose do të financohen me programet kombëtare të mbështetjes.

## 1.4 Kush mund të parashtrojë Deklaratë Interesi për një projekt për konsolidimin e tokës

Të drejtën e parashtrimit të Deklaratave të Interesit gëzojnë grupet e pronarëve të tokave bujqësore që janë të interesuar (toka bujqësore e të cilëve gjendet në të njëjtin territor të një apo më tepër fshatrave, apo brenda një fshati/pozicioni mikro, që paraqesin pjesë të një apo më tepër komunave rurale kadastrale fqinje). Pronar i tokës është person fizik apo juridik, i cili gëzon të drejtën e pronësisë mbi një toke bujqësore[1] në bazë të kontratës, vendimit gjyqësor, ose vendimit të një institucioni shtetëror.

## 1.5 Cilat zona konsiderohen të jenë zona të përshtatshme për konsolidimin etokës

Kur vendosin për shprehjen e interesit, grupet e interesuara të pronarëve të tokave duhet të marrin në konsideratë faktorët në vijim që karakterizojnë potencialin e zonës për konsolidimine tokës:

[1] *Tokë bujqësore, siç përcaktohet me Ligjin e Tokës Bujqësore, u referohet fushave të lëruara, tokave të lërueshme, kopshteve frutore, vreshtave, ullishteve, kulturave tjera shumëvjeçare, livadheve, kullotave, moçaleve, xunktheve, peshkimeve, si dhe tokave tjera të shfrytëzuara ose të pashfrytëzuara (jo të përshtatshme për kultivim), të cilat, me përdorimin e masave agro-mekanike dhe agro-meliorative dhe hidro-meliorative do të ishin shndërruar në tokë të përshtatshme për prodhimtari bujqësore.*

- *Pronësia e tokës bujqësore* – Toka bujqësore në pronësi private duhet të mbizotërojë, krahasuar me tokën në pronësi shtetërore;
- *Shkalla e copëzimit* – Numër të lart të formave jo të rregullta të tokës për pronar;
- *Veçoritë e terrenit dhe tokës* – Zona e propozuar e projektit për konsolidimine tokës duhet patur sa më pak trajtë të diversifikuar të terrenit dhe cilësi të tokës, aq sa është e mundur (për shembull – zona është e rrafshët) dhe cilësia më e njëtrajtshme e tokës (për shembull, klasa e njëjtë kadastrale);
- *Përqindja e tokës bujqësore e regjistruar në Kadastrën e Patundshmërive* – Shumica e tokavenë zonën e propozuar për konsolidimin e tokësqë janë regjistruar në Kadastrën e Patundshmërive;
- *Përfshirja e kulturave shumëvjeçare* – Zona e projektit të propozuar për konsolidimin e tokës duhet patur sa më pak parcela të mbuluara me kultura shumëvjeçare, aq sa është e mundur;
- *Prania e objekteve të paluajtshme në zonën e propozuar të projektit për konsolidimin e tokës* – Zona e propozuar e projektit për konsolidimin e tokës duhet patur sa më pak objekte të paluajtshme, aq sa është e mundur;
- *Toka e përpunuar* - Zona e propozuar e projektit për konsolidimin e tokës duhet të përfshijë sa më tepër toka të lërueshme dhe të përpunuara, aq sa është e mundur;

Në bazë të faktorëve të prezantuar më herët, kriteret e përzgjedhjes indikative janë zhvilluar dhe janë prezantuar më poshtë, në pjesën 1.6.

## 1.6 Kriteret e kualifikimit dhe përzgjedhjes indikative

### 1.6.1 Kriteret e kualifikimit

Domethënë, ato Deklarata Interesi, ku janë më pak se 90% të parcelave të tokës të regjistruara në Kadastrën e Patundshmërive (nga zona totale për të cilën po shprehet interesi për konsolidimin e tokës), do të eliminohen. Informacionet e posaçme për shkallën e regjistrimit të tokës do të sigurohen nga MBPEU, ashtu siç janë marrë nga Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive për të gjitha Deklaratat e Interesit.

### 1.6.2 Kriteret e përzgjedhjes indikative

Kriteret e përzgjedhjes indikative sipas të cilave do të rangohen Deklaratat e parashtruara të Interesit, janë prezantuar në tabelën e mëposhtme të vlerësimit:

| Nr. | Kriteret | Treguesi<br>Përshkrimi (Maksimumi – Minimumi) | Pikat<br>maks. – min. |
|---|---|---|---|
| 1 | **Shkalla e copëzimit të tokës në zonën e projektit të propozuar për konsolidimin e tokës** | Numri i parcelave të tokës për pronar<br>• Shumë e copëzuar – më tepër se 5 parcela të tokës për pronar<br>• Mesatare – nga 3 deri 5<br>• E ulët – deri 3 | 35 – 10 |
| 2 | **Veçoritë e terrenit dhe të tokës** | Pjerrësia e terrenit, diversiteti i trajtës së terrenit dhe cilësia e tokës<br>• Terren i sheshtë dhe cilësia e njëtrajtshme e tokës<br>• Terren paksa kodrinor me disa lloje të cilësisë së tokës<br>• Rajon malor me shumë lloje të cilësisë së tokës | 15 – 5 |
| 3 | **Përqindja e tokës bujqësore e regjistruar në Kadastrën e Patundshmërive** | Parcelat e regjistruara të tokës bujqësore në Kadastrën e Patundshmërive si përqindje e sipërfaqes së projektit për konsolidimin e tokës<br>• Më tepër se 97% të parcelave të tokës bujqësore brenda zonës së përgjithshme të propozuar për projektin e konsolidimit e tokës janë regjistruar në Kadastrën e Patundshmërive<br>• 90-97% | 10 – 3 |
| 4 | **Sipërfaqja e kulturave shumëvjeçare** | Raporti = zona nën kulturat shumëvjeçare / zona e projektit për konsolidimine tokës<br>• Më pak se 10% të tokës janë nën kultura shumëvjeçare<br>• Përqindja e tokës nën kultura shumëvjeçare është midis 10-30% brenda zonës së përgjithshme të propozuar për projektin e konsolidimit të tokës<br>• Përqindja e tokës nën kultura shumëvjeçare është më e lart se 30% brenda zonës së përgjithshme të propozuar për projektin e konsolidimit të tokës | 10 – 2 |
| 5 | **Prania e objekteve të paluajtshme në zonën e projektit të konsolidimit të tokës** | Numri i objekteve të paluajtshme dhe sipërfaqja e tyre në total<br>• Më pak se 3 objekte të paluajtshme, ose 0,1 ha sipërfaqe nën objekte të paluajtshme në total<br>• 3-10 ose 0,3 ha në total<br>• Më tepër se 10 objekte të paluajtshme, ose më tepër se 0,3 ha në total | 10 – 2 |
| 6 | **Toka e përpunuar** | Raporti = sipërfaqja e tokës bujqësore / zona e projektit të konsolidimit të tokës<br>• Më tepër se 90% të tokës janë të lërueshme<br>• Përqindja e tokës së lërueshme brenda zonës së përgjithshme të propozuar për projektin e konsolidimit të tokës është midis 70-90%<br>• Përqindja e tokës së lërueshme brenda zonës së përgjithshme të propozuar për projektin e konsolidimit të tokës është më pak se 70% | 20 – 3 |
| | | **Pikat maksimum 100** | |
| | | **Pikat minimum 25** | |

Pritet që përzgjedhja e zonave të projektit për konsolidimin e tokës të përfundohet dhe rezultatet do të prezantohen publikisht në fund të muajit korrik të vitit 2019.

# 2 PËRGATITJA DHE PARASHTRIMI I DEKLARATËS SË INTERESIT

## 2.1 Përbërja e DeklaratëssëInteresit

Pronarët e tokave që janë të interesuar detyrohen të përdorin dhe të plotësojnë formularin e përgatitur për këtë Thirrje (Aneksi 1), poashtu të disponueshme dhe në version elektronik.

Numri i pronarëve të tokës që do të nënshkruajnë Deklaratën e Interesit nuk është i kufizuar.

Një pronar i tokës mund të nënshkruajë një apo më tepër Deklarata Interesi, në rast se toka e tij shtrihet në zona të ndryshme.

## 2.2 Mbështetja e disponueshme për përgatitjen e Deklaratës së Interesit

Pronarët e tokave që janë të interesuar, në kuadrin e procesit të përgatitjes dhe parashtrimit të Deklaratës së Interesit, mund të marrin mbështetjen e:

- **Projektit "Integrimi i Programit Kombëtar për Konsolidimin e Tokës (MAINLAND)"**
  Aminta Treti, Nr. 2 (Zyra nr. 211)
  1000, Shkup
  Tel.: +389 2 3134 477 (lokali 708)
  E-mail-i: FAO-MK@fao.org

- **Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU)**
  Departamenti i Konsolidimit të Tokës, Shkëmbimit dhe Identifikimit të Parcelave
  Aminta Treti, Nr. 2 (Zyra nr. 211)
  Tel .: +389 2 3134 477 (lokalet 109,110,111)
  e-mail-i: info@mzsv.gov.mk; kiril.georgievski@mzsv.gov.mk

- **Zyrat Rajonale të MBPEU** (Aneksi 2)

- **Zyrat Rajonale të Agjencisë për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë** (ANZHB) (Aneksi 3)

Të gjitha informacionet ose lajmërimet në lidhje me Thirrjen mund të gjenden në ueb faqet e mëposhtme:

- www.fao.org/in-action/mainstreaming-national-land-consolidation-programme
- http://www.mzsv.gov.mk/Events.aspx?IdRoot=1&IdLanguage=3&News=535

Pronarët e tokave që janë të interesuar mund t'i kotaktojnë subjektet e përmendura më lart drejtpërsëdrejti, me postë, telefon ose me e-mail.

# 3 PROCEDURA PËR PËRZGJEDHJEN E ZONAVE TË PROJEKTIT

**Hapi 1 - Hapja**

Deklaratat e Interesit do të hapen më datë 5 korrik 2019, në hapësirat e projektitMAINLAND, pa prezencë publike.

**Hapi 2 – Plotësimi i Pyetësorit**

Me pranimin e Deklaratave të Interesi nga grupet e pronarëve të tokave që janë të interesuar, do të organizohen takime me pronarët e tokave që kanë shprehur interes.

Qëllimi i takimeve është që të tregohen më hollësishëm informacionet dhe të qartësohet qasja nga poshtë-lart, në bazë të procesit të konsolidimit të tokës.

Takimet me pronarët e tokave do të organizohen sipas fshatit, për të grumbulluar të dhëna plotësuese mbi zonën e propozuar, ashtu siç është shënuar në Pyetësorin (Aneksi 4).

Personi/personat i/e kontaktit do të ftohen t'i organizojnë gjithë pronarët e tokave që janë të interesuar e që kanë parashtruar Deklaratë Interesi, që të marrin pjesë në takimet e caktuara. Do të inkurajohet pjesëmarrje sa më e gjerë, sepse në këto takime, pronarët tjerë të tokave, të cilët parimisht nuk kanë nënshkruar Deklaratën e Interesit, mund të bashkëngjiten. Gjatë takimeve lokale, do të plotësohet Pyetësori nga përfaqësuesit e projektit MAINLAD dhe të MBPEU, nga Sektori i Konsolidimit të Tokës, Shkëmbimit dhe Identifikimit të Parcelave.

Të dhënat e grumbulluara gjatë këtyre takimeve do të verifikohen plotësueshëm sipas regjistrave administrativë.

**Hapi 3 - Verifikimi i të dhënave**

Për të siguruar objektivitetin dhe transparencën e procesit të vlerësimit në kuadrin e kritereve të përzgjedhjes indikative, korrektësia e informacioneve të prezantuara në Pyetësorët e plotësuar gjatë takimeve me komunitetet lokale dhe në Deklaratat e Interesit, do të verifikohen nga MBPEU dhe nga projekti MAINLAND, me shfrytëzimin e burimeve të të dhënave zyrtare në dispozicion.

Për të bërë verifikimin e të dhënave, do të shfrytëzohen burimet e mëposhtme të të dhënave:

| Nr. | Kriteret | Treguesi | Burimi i të dhënave |
|---|---|---|---|
| 1 | **Shkalla e copëzimit të tokës në zonën e projektit të konsolidimit të tokës** | Numri i parcelave të tokës për pronar | Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive |
| 2 | **Tiparet e terrenit dhe tokës** | Pjerrësia e terrenit, diversiteti i trajtës së terrenit dhe cilësia e tokës | Pyetësori, Sistemi i hartës së tokës, Universiteti i Shën Kirilit dhe Metodit |
| 3 | **Përqindja e tokës së regjistruar në Kadastrën e Patundshmërive** | Parcelat e tokës të regjistruara në Kadastër të Patundshmërive si përqindje e tokës totale në zonën e projektit të konsolidimit të tokës | Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive |
| 4 | **Përfshirja e kulturave shumëvjeçare** | Raporti = zona nën kulturat shumëvjeçare / zona e projektit të konsolidimit të tokës | Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës |
| 5 | **Prania e objekteve të paluajtshme në zonën e projektit të konsolidimit të tokës** | Numri i objekteve të paluajtshme dhe sipërfaqja e tyre në total | Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive,<br>Të dhënat e GIS |
| 6 | **Toka e përpunuar** | Raporti = sipërfaqja e tokës bujqësore / zona e projektit të konsolidimit të tokës | Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës |

**Hapi 4 - Rangimi**

Komisioni i Përzgjedhjes, i përbërë nga ekipi i MAINLAND dhe MBPEU, i kryesuar nga Këshilltari Kryesor Teknik, është përgjegjës për përzgjedhjen përfundimtare të zonave të projektit për konsolidimin e tokës. Përzgjedhja do të bëhet në bazë të rangimeve të Deklaratave të Interesit, në pajtim me kriteret e përzgjedhjes indikative të prezantuara në pjesën1.6.

12 Deklaratat e Interesit të ranguara më së larti e që kanë pikat më të larta, do të përzgjedhen për nisjen e projekteve për konsolidimin e tokës.

**Hapi 5 - Njoftimi në lidhje me rezultatet e përzgjedhjes**

Të gjithë pronarët e tokave që janë të interesuar, e të cilët kanë parashtruar Deklarata Interesi, zyrtarisht do të informohen me shkrim për rezultatet e tyre në procesin e përzgjedhjes.

Letrat e njoftimit do t’u dërgohen personave të kontaktit të secilit komuntet lokal, të shënuar në Deklaratat e parashtruara të Interesit.

## 4 KORNIZA KOHORE INDIKATIVE

| Aktiviteti | Korniza kohore indikative |
|---|---|
| Afati i fundit për parashtrimin e Deklaratave të Interesit | 1 korrik 2019 |
| Hapja e Deklaratave të Interesit | 5 korrik 2019 |
| Pohimi i interesit dhe gatishmërisë së komuniteteve lokale për pjesëmarrje në procesin e konsolidimit të tokës | 8 - 18 korrik 2019 |
| Verifikimi i të dhënave | 19 – 23 korrik 2019 |
| Përzgjedhja e zonave të projektit të konsolidimit të tokës | 24 - 26 korrik 2019 |
| Njoftimi në lidhje me rezultatet e përzgjedhjes | 31 korrik 2019 |

# ANEKSI 1. DEKLARATA E INTERESIT PËR PJESËMARRJE NË KONSOLIDIMIN E TOKËS

## DEKLARATA E INTERESIT PËR PJESËMARRJE NË PROJEKTIN PËR KONSOLIDIMIN E TOKËS BUJQËSORE

1. **Propozimi i zonës së konsolidimit i përket fshatit (fshatrave):**

    1. ________________________________________________

    2. ________________________________________________

    3. ________________________________________________

2. **Përshkrimi i zonës së propozuar të konsolidimit (**në kuadrin e KK, pozicionimi hapësinor në zonën e banuar, pjerrësia/trajta e terrenit, etj.)

____________________________________________________________________________

____________________________________________________________________________

____________________________________________________________________________

____________________________________________________________________________

3. **Llojet e produkteve më të shpeshta bujqësore** (në përqindje nga sipërfaqja e përgjithshme vlerësimi i përafërt i nivelit të zonës së banuar)

____________________________________________________________________________

____________________________________________________________________________

____________________________________________________________________________

____________________________________________________________________________

**Personat e kontaktit:**

**Kontakti 1`:**

Emri: ______________________________________

Mbiemri: ___________________________________

Nr. i tel.: ____________________________________

**Kontakti 2`:**

Emri: ______________________________________

Mbiemri: ___________________________________

Nr. i tel.: ____________________________________

Ky projekt është financuar
nga Bashkimi Evropian

Kyprojektpoimplementohet
nga FAO

**Lista e pronarëve të interesuar për konsolidimin e tokës**

*(lista mund të zgjerohet duke shtuar rreshte, sipas numrit të pronarëve të interesuar)*

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Adresa e banimit | Komuna kadastrale ku gjendet toka bujqësore | Fletëpronanr. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | |
| 2 | | | | | |
| 3 | | | | | |
| 4 | | | | | |
| 5 | | | | | |
| 6 | | | | | |
| 7 | | | | | |
| 8 | | | | | |
| 9 | | | | | |
| 10 | | | | | |
| 11 | | | | | |
| 12 | | | | | |
| 13 | | | | | |
| 14 | | | | | |
| 15 | | | | | |
| 16 | | | | | |
| 17 | | | | | |



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë
dhe Ekonomisë së Ujërave

# ANEKSI 2. LISTA E KONTAKTEVE TË ZYRAVE RAJONALE TË MBPEU

| Nr. | ZR MBPEU | Emri dhe mbiemri | Tel. celular | Tel. fiks | Adresa | E-mail-i |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Berovë | Goce Milloshevski | 072/204-514 | 033/470-081 | Rr. Dimitar Vllahov, nr. 10 | pe.berovo@mzsv.gov.mk |
| 2 | Manastir | Metodija Ilievski | 070/370-812 | 047/237-419 | Bul. 1 Maj, p.n. | pe.bitola@mzsv.gov.mk |
| 3 | Bogovinjë | Basri Ferati | 072/685-017 | | Komuna e Bogovinjes | pe.bogovinje@mzsv.gov.mk |
| 4 | Vallandovë | Vasko Kamçev | 071/388-743 | 034/381-752 | Rr. 4 Korriku, nr. 1 | pe.valandovo@mzsv.gov.mk |
| 5 | Veles | Zoran Nakovski | 070/390-328 | 043/231-931 | Rr. Panko Brashnar, nr. 1 | pe.veles@mzsv.gov.mk |
| 6 | Vinicë | Aco Anastasov | 070/403-869 | 033/361-319 | Rr. Bell Kamen, nr. 13 | pe.vinica@mzsv.gov.mk |
| 7 | Vrapçisht | Gëzim Hoda | 071/764-599 | | f. Negotinë, Komuna e Vrapçishtit | pe.vrapciste@mzsv.gov.mk |
| 8 | Vevçan | Tatjana Duckinoska | 071/304-984 | | Komuna e Vevçanit | pe.vevcani@mzsv.gov.mk |
| 9 | Gazi Babë | Goran Trenevski | 070/409-946 | 3226-414 | Bul. Aleksandar Makedonski, p.n. | pe.gazibaba@mzsv.gov.mk |
| 10 | Gjevgjeli | Dejan Markudov | 070/410-947 | 034/213-708 | Rr. Boris Karauzov, p.n. | pe.gevgelija@mzsv.gov.mk |
| 11 | Gostivar | Ali Elezi | 070/622-019 | 042/214-464 | Bul. Braqa Ginovski, p.n. | pe.gostivar@mzsv.gov.mk |
| 12 | Dibër | Arben Mulladauti | 071/367-459 | 046/832-134 | Rr. 8 Shtatori, p.n. | pe.debar@mzsv.gov.mk |
| 13 | Dellçevë | Illçe Karanfillovski | 070/410-954 | 033/413-282 | Rr. Sollunska, p.n. | pe.delcevo@mzsv.gov.mk |
| 14 | Demir Hisar | Zoran Mlladenovski | 070/403-786 | 047/276-329 | Rr. Marshall Tito, p.n. | pe.demirhisar@mzsv.gov.mk |
| 15 | Kavadar | Mitko Kerov | 070/410-962 | 043/415-188 | Rr. Bllazho Aleksov, p.n. (ish ndërtesa e Kadastrës) | pe.kavadarci@mzsv.gov.mk |
| 16 | Karposh | Sasho Leonidov | 070/403-857 | 02/3065-771 | Rr. Aminta III, nr. 2 | pe.karpos@mzsv.gov.mk |
| 17 | Kisella Vodë | Boro Kaevski | 070/410-434 | 02/2779-199 | Rr. Boris Trajkovski, p.n. (baraka 9) | pe.kiselavoda@mzsv.gov.mk |
| 18 | Kërçovë | Snezhana Sofronievska | 071/367-414 | 045/225-175 | Rr. Boris Kidriç, nr. 1 | pe.kicevo@mzsv.gov.mk |
| 19 | Koçan | Gorançо Milldainov | 070/410-961 | 033/272-124 | Rr. VMRO, nr. 21 | pe.kocani@mzsv.gov.mk |
| 20 | Kratovë | Lube Cvetanov | 078/405-158 | 031/482-699 | Rr. Marshall Tito, p.n. | pe.kratovo@mzsv.gov.mk |
| 21 | Kriva Pallankë | Ivica Bojkovski | 070/410-433 | 031/376-606 | Rr. Shën Joakim Osogovski, nr. 175 | pe.krivapalanka@mzsv.gov.mk |
| 22 | Krushevë | Sllavica Stefanovska | 070/403-850 | 048/477-359 | Rr. Nikolla Gjurkoviç, p.n. | pe.krusevo@mzsv.gov.mk |
| 23 | Krivogashtan | Kosta Durllanov | 070/403-862 | | Komuna e Krivogashtanit | pe.krivogastani@mzsv.gov.mk |
| 24 | Kumanovë | Naser Dauti | 070/403-849 | 031/426-727 | Rr. 11 Tetori, p.n. | pe.kumanovo@mzsv.gov.mk |
| 25 | Makedonski Brod | Adrijana Llabroska | 070/403-846 | 045/274-770 | Rr. 7 Shtatori, nr. 4 | pe.makedonskibrod@mzsv.gov.mk |
| 26 | Negotinë | Minov Sashko | 070/390-116 | 043/365-299 | Rr. Aco Axhiilov, p.n. | pe.negotino@mzsv.gov.mk |
| 27 | Ohër | Sashu Sukllovski | 070/410-952 | 046/262-476 | Rr. Dimitar Vllahov, nr. 57 | pe.ohrid@mzsv.gov.mk |
| 28 | Pehçevë | Eleonora Dimitrov | 071/703-488 | 033/441-404 | Rr. Marshall Tito, p.n. | pe.pehcevo@mzsv.gov.mk |
| 29 | Prilep | Zoran Paçesheski | 078/694-847 | 048/422-571 | Rr. Pitu Guli, nr. 2 | pe.prilep@mzsv.gov.mk |
| 30 | Probishtip | Kuzev Darko | 078/230-668 | 032/483-124 | Rr. Jakim Stojkovski, nr. 1 | pe.probistip@mzsv.gov.mk |
| 31 | Radovish | Stojan Angellov | 070/410-948 | 032/635-605 | Bul. Aleksandar Makedonski, p.n. | pe.radovis@mzsv.gov.mk |
| 32 | Resnje | Igor Ivanovski | 070/390-128 | 047/451-467 | Rr. Car Samoill, p.n. | pe.resen@mzsv.gov.mk |
| 33 | Shën Nikollë | Dejan Giçev | 070/390-184 | 032/443-640 | Rr. Plloshtad Ilinden, p.n. | pe.svetinikole@mzsv.gov.mk |
| 34 | Strugë | Arieta Veliu | 071/322-107 | 046/786-433 | Rr. Marshall Tito, nr. 54 | pe.struga@mzsv.gov.mk |
| 35 | Strumicë | Vasill Kocev | 070/410-431 | 034/346-290 | Rr. Luba Barshnarska, nr. 5 | pe.strumica@mzsv.gov.mk |
| 36 | Tetovë | Afrim Sejrani | 070/409-934 | 044/338-873 | Rr. Dervish Cara, nr. 68 | pe.tetovo@mzsv.gov.mk |
| 37 | Çair | Mlladen Kollariç | 070/403-859 | 02/2612-783 | Rr. Bosnja e Hercegovina (baraka 19 dhoma 14) | pe.cair@mzsv.gov.mk |
| 38 | Shtip | Pavell Ivanov | 070/410-946 | 032/385-071 | Rr. General Mihajllo Apostolski, p.n. | pe.stip@mzsv.gov.mk |

# ANEKSI 3. LISTA E KONTAKTEVE TË ZYRAVE RAJONALE TË AGJENCISË PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË

| Nr. | NJR ANZHB | Emri dhe Mbiemri | Tel. celular | Adresa | E-mail-i |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Zyra Qëndrore | Zllatko Sireta | 072 252 431 | Kl. Ohridski, p.n., Pellagonka II-5/3 7000 Manastir | aprzdirekcija@agencija.gov.mk |
| 2. | NJR Shkup | Vlladimir Georgiev | 072 262 623 | III Makedonska Brigada, nr. 10, Shkup | aprzrcskopje@agencija.gov.mk |
| 3. | NJR Tetovë | Petre Petreski | 072 244 481 | 29 Noemvri, p.n., Tetovë | aprzrctetovo@agencija.gov.mk |
| 4. | NJR Gostivar | Jelica Beshliç | 070 409-096 | Beliçica, nr. 123, Gostivar | aprzregostivar@agencija.gov.mk |
| 5. | NJR Kumanovë | Xhabir Ramadani | 070 409 110 | Bratstvo i edinstvo, nr. 28, Kumanovë | aprzrckumanovo@agencija.gov.mk |
| 6. | NJR Shën Nikollë | Jordançe Petkov | 070 409 114 | Leninova, p.n., Shën Nikollë | aprzresvnikole@agencija.gov.mk |
| 7. | NJR Veles | Stefan Eçev | 072 244 470 | Panko Brashnarov, nr. 1, Veles | aprzreveles@agencija.gov.mk |
| 8. | NJR Manastir | Mirjana Miling | 070 409 005 | Novaçki pat, p.n., Manastir | aprzrcbitola@agencija.gov.mk |
| 9. | NJR Prilep | Goranço Tomevski | 070 409 081 | Lenin, nr. 127, Prilep | aprzreprilep@agencija.gov.mk |
| 10. | NJR Resnje | Goran Stefanoski | 070 409 075 | Boris Kidriç, p.n., Resnje | aprzreresen@agencija.gov.mk |
| 11. | NJR Ohër | Bilana Gjorçeska | 070 409 064 | Dimitar Vllahov, nr. 60, Ohër | aprzreohrid@agencija.gov.mk |
| 12. | NJR Strugë | Slagjana Kallajxhieska | 070 409 073 | Gradski Pazar (Pazari i Qytetit), p.n., Strugë | aprzrestruga@agencija.gov.mk |
| 13. | NJR Kavadar | Draganço Nikollov | 070 409 076 | Partizanska, p.n., Kavadar | aprzrekavadarci@agencija.gov.mk |
| 14. | NJR Negotinë | Gjorgji Ajtov | 070 409 043 | Marshall Tito, p.n., Negotinë | aprzrenegotino@agencija.gov.mk |
| 15. | NJR Strumicë | Tankica Smillanova | 070 409 103 | Leninova, p.n., Strumicë | aprzrcstrumica@agencija.gov.mk |
| 16. | NJR Gjevgjeli | Toni Mushanov | 070 409 124 | Industriska, nr. 1, Gjevgjeli | aprzregevgelija@agencija.gov.mk |
| 17. | NJR Shtip | Mite Nikollovski | 070 409 019 | Zheleznięka, nr. 7-a, Shtip | aprzrcstip@agencija.gov.mk |
| 18. | NJR Koçan | Valentin Zahariev | 070 409 143 | Nikolla Karev, p.n., Koçan | aprzrekocani@agencija.gov.mk |
| 19. | NJR Vinicë | Vanço Zahariev | 070 409 053 | Braqa Milladinovci, p.n., Vinicë | aprzrevinica@agencija.gov.mk |
| 20. | NJR Kërçovë | Lupçe Danilloski | 070 409 102 | Mirko Mileski, nr. 4, Kërçovë | aprzrekicevo@agencija.gov.mk |

## ANEKSI 4. PYETËSORI PËR GRUMBULLIMIN E INFORMACIONEVE PLOTËSUESE PËR KOMUNITET LOKAL

1. **Madhësia e zonës së propozuar për konsolidimin e tokës (ha):__________________**
2. **Raporti midis tokës private dhe shtetërore brenda zonës së propozuar për konsolidimin e tokës (%)**
   a. Pronësi private __________
   b. Pronësi shtetërore ________
3. **Nr. i parcelave të tokës brenda zonës së propozuar për konsolidimin e tokës _____________**
4. **Nr. i pronarëve të tokave që janë interesuar për konsolidimin e tokës __________________**
5. **Përshkrimi i zonës së propozuar për konsolidimin e tokës (emri i zonës, tiparet gjeografike, etj.)**
6. **Prania e objekteve brenda zonës së propozuar për konsolidimin e tokës:**

| **Lloji** | **Nr. i objekteve** | **Totali i tokës nën objekte** |
|---|---|---|
| Serra | | |
| Tunele najlloni / serra | | |
| Objekte me karakter të përhershëm (nr. i objekteve, përshkrimi, zona totale nën objekte) | | |

7. **Përshkrimi i infrastrukturës brenda zonës së propozuar për konsolidimin e tokës:**

| | |
|---|---|
| Ekzistimi i rrugëve rurale | |
| Sistem(e) të ujitjes | |
| Sistem(e) të drenazhimit (shkarkimit) | |

**Pyetjet që duhet të plotësohen nga MBPEU:**

a) Përqindja e parcelave të tokës bujqësore të regjistruara në Kadastrën e Patundshmërive (burimi- AKP)_____________________________________________________________________________

b) Përfshirja e kulturave shumëvjeçare (burimi- SIPT) ___________________________________